

Nextar's MajoRi
Rifaz Hamizi
Hazir Memizi

○ ○
Për nivelin
e dytë

UNË DHE TË TËJËRËT



EMRI DHE MARRËMIA _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

VENDI _____

SHTETI _____

Këtë libër e gjeni edhe në versionin elektronik dhe mund ta shkarkoni nga uebfaqja e MASH Të Kosovës <http://www.mashit.gov.net>



duk gjini

Nexhat Maloku, Rifat Hamiti, Hazir Mehmeti

UNË DHE TË TJERËT

Fletore tematike
për nivelin e dytë

duk^agjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Sylja.

Hartues/e të këtij teksti: Nexhat Maloku, Rifat Hamiti, Hazir Mehmeti

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

1. Grindje shoqesh.....	4
2. Familja e Petritit.....	7
3. Jemi shqiptarë.....	9
4. Loja me topa bore.....	11
5. Njëzet nëntori.....	14
6. Vizita e gjyshit dhe e gjyshes.....	17
7. Vendasi i huaj.....	21
8. Humbe gjuhën, je i humbur.....	23
9. Fqinjët tanë.....	25
10. Një dhuratë për gjyshen.....	27
11. Te mjeku.....	29
12. Një ditë pushimi.....	32
13. Ç'do të bëhem.....	34
14. Si e ëndërroj të ardhmen time.....	36
15. Si banojnë fëmijët e një klase.....	40
16. Një vizitë në muzeun e qytetit.....	43
17. Rolet e vajzave dhe të djemve.....	45
18. Trupi im më përket mua.....	48
19. Albana u ndihmon fqinjëve të rinj.....	50
20. Dëshirat e përafërta.....	53



1. Grindje shoqesh

Ishte pasdite e së hënës. Mësuesi i gjuhës shqipe duke hyrë në klasë vuri re që dy nxënese po grindeshin me dy nxënese të tjera. Duke parë këtë situatë të tendosur, vendosi që të fliste me to.

Mësuesi: - Unë e shoh që ju jeni të mllefosura shumë në njëra-tjetrën. Më tregoni çfarë ka ndodhur?

Diana: - Po, mësues, Merita dhe Vlora na kanë përqeshur. Për këtë arsye jemi shumë të hidhëruara me to.

Merita: - Nuk është e vërtetë, mësues, ato vetëm po thonë ashtu. Ne nuk i kemi përqeshur.

Mësuesi: - A mund të më tregosh, Blerinë, se si ndodhi ngjarja?

Blerina: (Shumë e mllefosur) – Diana dhe unë shkojmë në një kurs vallëzimi hip-hop këtu në shkollën tonë. Deri para dy javësh edhe Merita e Vlora ishin me ne, por pastaj ato u çlajmëruan me arsyetimin se kanë shumë detyra për të bërë. Por ato kanë pasur një arsye tjetër, ato duan të tregohen se janë më të mira se unë dhe Diana në mësim.

Vlora: Nuk është ashtu, mësues. Dianës i vjen inat që Merita i ka notat më të mira në klasë dhe ajo gjithnjë shpif për të.

Mësuesi: - Dhe çfarë ndodhi pastaj?

Diana: - Pasi ato nuk vinin më, erdhën dje të na shihnin si po vallëzonim. Te dera e sallës ato na shikonin dhe na përqeshnin para djemve dhe mësueses së vallëzimit, duke na thënë se nuk dimë të vallëzojmë dhe se i lëvizim këmbët si patat.

Merita: - Mund të betohem që ne nuk i kemi përqeshur. Vetëm i kemi shikuar pak dhe jemi larguar.

Mësuesi: - Unë mendoj që ju po flisni për njëra-tjetrën me hamendje. Kështu ju e dëmtoni shoqërinë tuaj. Por unë kam një ide. Ju do të shkruani secila për vete se si e keni përjetuar këtë grindje. Mundohuni të jeni sa më të arsyeshme. Jepni edhe ndonjë mendim si mund të zgjidhet kjo grindje mes jush. (Vajzat filluan të shkruanin. Përnjëherësh u krijua një qetësi. Mësuesi po i ndiqte me vëmendje. Ai mezi priste të lexonte mendimet e tyre.)

Përgjigju pyetjeve nga teksti:

1. Përse mësuesi nuk filloi me mësimin?
2. Çka vendosi ai?
3. Kush me kë ishte në grindje?
4. Përse ishin të zemëruara Blerina dhe Diana?
5. Përse ishin çlajmëruar Vlora dhe Merita nga kursi?
6. Në çka e mbështetnin mendimin e tyre Blerina e Diana?
7. Çfarë vendosi të bënte mësuesi?

Analizo!

1. A kishin arsye Blerina e Diana t'i akuzonin shoqet e tyre? _____

2. Sa ishin ato bindëse për hamendjen e tyre? _____

3. Pse Vlora dhe Merita nuk e pranonin akuzën e tyre? _____

4. Si do të veproje ti po të ishe në vend të Blerinës dhe të Dianës? _____

Thellohu!

Mundohu të shkruash një përfundim të tregimit. Shpreh mendimet e tua. Mund të bisedosh paraprakisht edhe me shokun/ shoqen e bankës



2. Familja e Petritit

Familja ime jeton në një qytet të Zvicrës. Babai im ka emigruar këtu qysh para tridhjetë vjetësh. Babai im është martuar me nënën time në vitin 1986. Në fillim të viteve nëntëdhjetë babai e mori nënën dhe vëllanë tim, i cili ka lindur në Kosovë. Berati, Rina dhe unë kemi lindur në mërgim, pra në qytetin ku tash jetojmë. Neve na pëlqen shumë jeta këtu. Babai e nëna punojnë, kurse ne fëmijët shkojmë ende në shkollë. Këtu nuk kemi asnjë të afërm. Neve na mungon shumë farefisi ynë. Por në qytetin tonë ka edhe plot familje të tjera shqiptare nga Kosova, Maqedonia e Shqipëria. Gjatë festave tubohemi dhe kremtojmë. Me disa prej familjeve kemi kontakte të vazhdueshme.

Familja ime e gjerë jeton në Kosovë. Unë kam gjyshin e gjyshen, dy teze, tri halla, dy xhaxhallarë dhe shumë kushërinj e kushërira. Gjyshi e gjyshja jetojnë te xhaxhai im, sepse atje nuk ka shtëpi të pleqve. Njëra nga hallat e mia ka mbetur e ve, ngase burri i saj është vrarë gjatë luftës në Kosovë. Ajo mban një fotografi të burrit të saj në murin e dhomës së ditës dhe unë mendoj që ajo vuan shumë. Ajo thotë se nuk do të martohet. Mua më do shumë dhe gjithnjë kur shkoj tek ajo më jep sende të ndryshme për të ngrënë.

Kur shkojmë për pushimet e verës në Kosovë, ne i vizitojmë të gjithë të afërmit tanë. Unë kënaqem duke luajtur me kushërinjtë. Atje ndihem aq mirë dhe jam shpesh i gëzuar. Mua më pëlqen shumë fshati, ku jeton familja ime e gjerë. Në fshat mund të shkoj nga të dua. Të gjithë ata që jetojnë aty janë një fis. Verës bëhen disa dasma. Në dasma vijnë shumë mysafirë. Nën tingujt e muzikës dasmorët festojnë deri në orët e vona të natës. Ne fëmijët luajmë lojëra të ndryshme. Unë bëj shumë xhirime me kamerën digjitale, të cilën ma ka blerë babai për ditëlindje. Këto do të jenë kujtime të jashtëzakonshme për të gjithë ne.

1. Përgjigju pyetjeve!

1. Ku jeton familja e Petritit?
2. Kur kishte emigruar ajo?
3. Kush u mungon shumë atyre?
4. Kë ka ai prej familjes së gjerë në Kosovë?
5. Pse ka mbetur e ve njëra nga hallat?
6. Si ndihet Petriti kur shkon në Kosovë?
7. Çfarë bën ai me kamerë?


2. Plotëso fjalitë!

1. Babai e nëna _____
2. Unë kam _____
3. Ajo mban një _____

3. Përgjigju pyetjeve me shkrim!

1. Përse emigrojnë njerëzit?
2. Sa shpesh shkon në Atdheun tënd?
3. Ku të pëlqen më shumë të jetosh? Pse?

4. Vizato shtëpinë tënde në Atdhe ose atë të të afërmve të tu!





3. Jemi shqiptarë

Gjini dhe Merita janë shqiptarë. Gjini vjen nga Kosova, kurse Merita nga Maqedonia. Ata shkojnë në të njëjtën shkollë në qytetin ku jetojnë. Klasa e tyre është e përbërë nga nxënësë e nxënës vendës, si dhe të shteteve të ndryshme të botës.

Në klasën e katërt, ku Gjini dhe Merita vijojnë mësimin, janë gjithsej njëzet e katër nxënësë e nxënës. Ata flasin tetë gjuhë të ndryshme si gjermanisht, anglisht, italisht, shqip, frëngjisht, spanjollisht, kinezisht dhe tamilisht.

Një ditë mësuesja e klasës, pasi shpjegoi një temë për kulturat dhe religjionet e ndryshme, i pyeti nxënësit për përkatësinë religjioze të familjeve të tyre. Disa nxënës u përgjigjen se kanë përkatësi religjioze katolike, të tjerë myslimane, dy nxënës religjionin hindu. Kur mësuesja dëgjoji se Gjini kishte përkatësi religjioze katolike, kurse Merita atë myslimane, u bë kureshtarë dhe i pyeti se përse është kështu kur ata të dy ishin shqiptarë. Dhe Gjini e Merita u treguan kolegëve të tyre se shqiptarët i kanë tri konfesionet, por asnjëherë nuk kanë pasur konflikte ndërfaqetare. Në shqiptarët identifikohemi në rend të parë sipas përkatësisë kombëtare, pra në rend të parë ne jemi shqiptarë, u thanë ata shokëve të tyre. Disa nxënës u habitën kur Merita tregoi se edhe Nëna Tereze është shqiptare. Ajo u tha atyre se Nëna Tereze ka lindur pikërisht në qytetin prej nga vjen ajo, pra në Shkup.

- Të dashur nxënës, - iu drejtua mësuesja atyre, - siç po e shihni, ne kemi përkatësi religjioze të ndryshme. Ju jetoni këtu së bashku në harmoni dhe e respektoni njëri-tjetrin. Çdokush ka të drejtë të besojë në religjionin e vet. Kurse Gjini e Merita, edhe pse kanë religjione të ndryshme, për ta është me rëndësi që para se gjithash janë shqiptarë, - përfundoi ajo. Merita e shikoi Gjinin me admirim. Ajo ishte krenare që kishte një bashkatdhetar në klasë si Gjinin.

1. Përgjigju pyetjeve:

1. Prej nga janë Gjini dhe Merita?
2. Cilat gjuhë i flasin shokët dhe shoqet e tyre?
3. Çfarë teme shpjegoi një ditë mësuesja e klasës?
4. Pse u bë kureshtarë mësuesja?
5. Çfarë u treguan Gjini dhe Merita shokëve dhe shoqeve të tyre?
6. Çfarë u tha mësuesja e nxënësve në fund?

2. Përgjigju pyetjeve vijuese me shkrim:

1. Çka të pëlqen te personazhi i Gjinit dhe i Meritës?
2. Çka di ti për religjionet e shqiptarëve?
3. Çka mendon ti, pse mësuesja iu drejtohet në fund nxënësve ashtu?

3. Shkruaj çfarë objektsh fetare janë këto:



4. Shkruaji emrat e disa festave religjioze të religjioneve të ndryshme që i njeh. Shkruaji emrat a) shqip dhe b) në gjuhën e vendit ku jeton!

5. Shkruaj cilat festa religjioze i feston në familje! Përshkruaje si e feston ti një nga ato!



Lyra Zajmi, Maskotë për Sharrin

4. Loja me topa bore

Ishte kohë dimri. Nxënësit e shkollës shqipe mezi prisnin që të dilnin në pushim, që të luanin me topa bore.

Kur dolën jashtë, Fatoni me Durimin, Petritin dhe Albanin hynë në fushën ku të tjerët tashmë kishin filluar të luanin me borë. Fatoni, pasi e gjuajti një nxënës të klasës së katërt disa herë, e zuri nga koka dhe e rrëzoi përtokë. Pastaj ia mbushi qafën me borë. Nxënësi i rrëzuar, Flamuri, mundohet të çlirohet, por kot. Duke parë këtë situatë të pakëndshme, Durimi vrapoi dhe e tërhoqi Fatonin nga krahët. Flamuri, duke qarë, mundohet ta hiqte borën e ftohtë nga qafa. Gjatë kësaj kohe, mësuesja e shkollës shqipe e kishte vëzhguar lojën e nxënësve nga dritarja dhe kur pa që Flamuri po qante, doli jashtë dhe i futi brenda.

- Flamur, pse po qan? – e pyeti mësuesja.

- Fatoni më rrëzoi me kokë në tokë, mësuese, - u përgjigj ai duke dënesur.

- Mësuese, ne vetëm kemi luajtur dhe... - u mbundua të fliste ai, por Durimi e ndërpreu.

- Ti e ke rrëzuar me kokë për toke dhe kjo është e palejueshme,- tha ajo.

Fatoni u ndje ngushtë. Ai po e kuptonte se i kishte thyer rregullat e lojës.

- Të betohem, mësuese, nuk e kisha me qëllim,- tha Fatoni.

Pastaj u drejtua nga Flamuri dhe i kërkoi falje për veprimin e bërë. Mësuesja i urdhëroi të uleshin në vendet e tyre dhe pasi u tregoi që i kishte vëzhguar nga dritarja, u tha:

- Ne kemi mësuar që edhe loja i ka rregullat e saj. Bile ju vetë i keni shkruar ato. Loja është për t'u kënaqur, jo për t'i shkaktuar tjetrit dhembje. Ti Durim, veprime shumë mirë që e tërhoqe Fatonin. Ndërkaq ti Faton në pushimin e orës tjetër do të rrish në klasë dhe do të lexosh rregullat e lojës,
- përfundoi ajo.

Fatoni u mërzit mjaft me këtë dënim që i dha mësuesja. Por në anën tjetër e kuptoi që vetë ishte fajtor për këtë.

1. Përgjigju pyetjeve:

1. Pse nxënësit mezi prisnin të dilnin në pushim?
2. Çka bëri Fatoni?
3. Çfarë ndodhi me Flamurin?
4. Çfarë bëri Durimi?
5. Kush e kishte parë këtë situatë?
6. Çfarë dënimi i dha mësuesja Fatonit?

2. Diskuto!

1. Cilat janë disa nga rregullat për lojën?
2. Çka nuk të pëlqen te veprimi i Fatonit?
3. Po veprimi i Durimit si të duket?
4. Si të duket dënimi që i jep mësuesja Fatonit?

3. Lexoje tekstin dy herë. Shkruaj në mënyrë të përmbledhur mendimet kryesore!



5. Njëzet Nëntori

Një ditë mësuesja e shkollës shqipe i pyeti nxënësit e klasës së saj:

- Kush më thotë pse dita e sotme është një datë e veçantë?

Nxënësit shikuan njëri-tjetrin sikur donin të gjurmonin në kujtesën e tyre. Por asgjë nuk u binte ndër mend që mund të lidhej me atë ditë. Nxënësit i drejtuan sytë nga mësuesja plot kureshtje të dinin se çka është njëzet nëntori.

- Sot është dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve, pra të drejtave tuaja, - tha ajo.

- Ahh, tash më kujtohet edhe mua, - tha Arbri, - sepse edhe mësuesja ime e klasës na ka folur për këtë ditë.

- Pasi kjo është dita e të drejtave tuaja, ju do të flisni sot për këtë.

Nxënësve u pëlqeu kjo ide. Por edhe e kishin pak të vështirë të dinin saktësisht se cilat janë të drejtat e tyre. Për këtë u erdhi në ndihmë mësuesja. Ajo mori katër letra të formatit të madh dhe shkroi në krye të tyre të drejtat, përgjegjësitë, nevojat dhe dëshirat e fëmijëve. Nxënësit u ndanë në katër grupe dhe për një çerek ore shkruan krejt çka mendonin se u përgjigjej këtyre temave. Pastaj nga secili grup një nxënës bëri prezentimin.

Pasi i dëgjuan prezentimet, nxënësit dhe mësuesja bënë një diskutim të zjarrtë .

- Pra, siç po shihni, përpos të drejtave, ju keni edhe përgjegjësitë tuaja. Ju keni shkruar edhe shumë dëshira. Por jo të gjitha dëshirat mund të plotësohen. Kjo varet edhe nga mundësitë e prindërve tuaj, - tha ajo. Në fund, nxënësit filluan të bënin nga një vizatim për të shprehur dëshirat e tyre.

1. Përgjigjju pyetjeve!

1. Përse i pyeti mësuesja nxënësit/et?
2. Kujt iu kujtua kjo datë dhe përse?
3. Për çka kishin vështirësi nxënësit dhe kush i ndihmoi ata?
4. Në sa grupe u ndanë nxënësit dhe çfarë bëri një nxënës nga secili grup në fund?
5. Pse nuk mund të plotësohen të gjitha dëshirat?
6. Çfarë vizatuan nxënësit?

2. Plotëso fjalitë!

1. Shkruaj një të drejtë që ka mundur ta shkruajë grupi i të drejtave!

2. Shkruaj një përgjegjësi që ka mundur ta shkruajë grupi i përgjegjësive!

3. Shkruaj një nevojë të cilën ka mundur ta shkruajë grupi i nevojave!

4. Shkruaj disa dëshira që ka mundur t'i shkruajë grupi i dëshirave!

3. Shkruaj për veten tënde...

1. ... disa të drejta që i ke në familjen tënde

2. ... disa përgjegjësi që i ke në familje _____

3. Cilat dëshira i ke lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë në familje?

4. Si vepron kur nuk të plotësohet ndonjë dëshirë?

4. Kërko në internet: A mund të gjesh diçka për të drejtat e fëmijëve në gjuhën shqipe apo të vendit ku jetoni? Trego në klasë!



6. Vizita e gjyshit dhe e gjyshes

Gjyshi dhe gjyshja e Dafinës po vinin për vizitë te familja e saj në Zvicër. Ajo kishte dalë në aeroport me babanë për t'i pritur. Kur gjyshi e gjyshja dolën para tyre, ajo iu hodh në qafë dhe i përqafoi me mall. Kishte shumë kohë që nuk i kishte parë.

Gjyshi e gjyshja, edhe pse të lodhur, ishin shumë kureshtar, sepse po udhëtonin për herë të parë në një vend jashtë Kosovës. Dafina e mori gjyshen për dore dhe u nisën për te makina. Pas një ore ata u gjendën para banesës së tyre. Nëna e Dafinës kishte dalë t'i priste. Atë mbrëmje ata u kënaqën duke biseduar. Gjyshi tregonte për të gjithë familjarët. Aty nga ora nëntë Dafina shkoi të flinte, sepse të nesërmen kishte mësim.

Të nesërmen, sapo u kthye nga shkolla, Dafina i pyeti gjyshin e gjyshen se si ishin Mentori, Arlinda dhe Gëzimi. Gjyshi i tregoi se Arlinda po mëson shumë në shkollë. Ajo ia kishte dërguar një album me fotografi Dafinës. Në album ishin disa fotografi shumë të vjetra. Dafina u ul mes gjyshit e gjyshes dhe filloi t'i pyeste për fotografitë.

- Këtu është babai im, apo stërgjyshi yt, - tha gjyshi, - kurse ky këtu është vëllai im e kjo motra ime.

- Janë shumë njerëz në këtë fotografi, - tha Dafina.

- Eh bija ime, atëherë familja jonë ishte e madhe dhe të gjithë jetonim bashkë, jo si tash që jemi shpërndarë nëpër botë, - tha gjyshja.

- Ua, gjyshe, sa bukur dukesh ti në këtë fotografi! - tha Dafina, e cila kishte gjetur një fotografi ku gjyshja kishte dalë kur ishte nuse. Në kokë gjyshja kishte një vello të bardhë.

Gjyshja i tregoi Dafinës për ditën e martesës së saj, pastaj për kohën që kishte jetuar me gjyshin etj. Dafina mësoi shumë gjëra të reja për jetën e gjyshes dhe të gjyshit.

Por ditët kaluan shumë shpejt dhe erdhi koha kur ata duhej të ktheheshin. Tërë familja i përcolli me lot në sy.

- Mos u mërzit, bija ime. Ja edhe disa muaj dhe ju do të vini për pushime në fshatin tonë, - i tha gjyshja Dafinës dhe e përqafoi fort.

- Udhë mbarë, gjyshe e gjysh! Të fala të gjithëve!- mezi foli Dafina mes lotëve.

Pasi kaluan kontrollin e pasaportave, Dafina me babanë dhe nënën të pikëlluar, i përshëndetën edhe një herë. Ata, ashtu të kërrusur e duke u mbajtur për njëri-tjetrin, nuk u dukën më.

1. Përgjigju pyetjeve nga teksti!

1. Kush po vinte te Dafina?
2. Pse ishin kureshtarë gjyshi dhe gjyshja e Dafinës?
3. Kush kishte dalë t'i priste?
4. Çfarë i kishte dërguar Arlinda Dafinës?
5. Çfarë i tregoi gjyshja Dafinës?
6. Si u përshëndet Dafina me gjyshin dhe me gjyshen e saj?

2. Ku jetojnë gjyshi dhe gjyshja jote?

3. Plotëso fjalitë!

1. Në fotografinë në të cilën ishte gjyshi ishin edhe _____

2. Në fotografi kishte shumë njerëz, sepse më herët në Kosovë familja _____

3. Familja e gjerë e Dafinës është e shpërndarë nëpër botë, sepse _____

4. Lidh atë që i përgjigjet

- | | |
|----------------------------|------------------|
| 1. Motra e nënës është | gjyshja ime. |
| 2. Vëllai i babait është | është halla ime. |
| 3. Motra e babait | daja im. |
| 4. Vëllai i nënës është | tezja ime. |
| 5. Nëna e nënës sime është | xhaxhai im. |

5. Shkruaj emrat nënë, baba, motër, vëlla, kushëri, kushërirë, tezë, dajë, gjysh, gjyshe etj. në gjuhën e vendit ku jeton ti!

6. Shqiptarët janë të njohur për mikpritjen e tyre. Shkruaj në një fletë të veçantë si i pritni ju në familje mysafirët tuaj!

7. Gjej fotografi ku duken gjyshi dhe gjyshja. Përshkruaj si duken ata në fotografi.

DËGJOJMË E KËNDOJMË

Shumë këngë të bukura i janë kushtuar gjyshes. Njëra ndër to është kënga e kënduar nga këngëtarja e shquar shqiptare Vaçe Zela.

“Kënga e gjyshes”

I

Sot një këngë do këndoj veç për ty, o gjyshja ime,
e di mirë dhe se harroj të shkaktova shumë trazime.
Këngën time ta kushtoj e të falur të kërkoj
sa shumë faje e gabime net pa gjumë edhe mundime.

II

Ti u zbardhe gjyshja ime e çdo ditë një rrudhë ta shtoj
Sa kokëqarje shqetësime sjellja ime të shkaktoi
Por ti je gjithnjë e mir' edhe fajin fshehtas fal
t'jem e urt un kam dëshirë kurse vrullin dot se ndal .

III

Un' fëmij kam qenë njeherë e pran' zjarrit me ty rrija
më tregoje ti atëherë shumë gjëra që un' si dija .
Un' dëgjoja gjithë çudi, plot kureshtje kënaqësi
e sa shumë nga ti mësoja me sa vrull të përqafoja.

IV

Shkuan vitet dhe tani s'jam e vogël si atëherë,
por o gjyshe dhe tani ta prish qejfin ndonjëherë.
Por se flas edhe sot për cdo gjë ti më beso
e shikimi yt i mirë më jep forcë të jem e lirë .

Këngën e kënduar nga Vaçe Zela mund ta gjeni në Youtube në këtë lidhje:

http://www.youtube.com/watch?v=G3_3ygyY-ag

Kurse po aq e bukur është një këngë tjetër për gjyshen, e cila është këngë për fëmijë dhe mund të mësohet shumë lehtë për t'u kënduar.

<http://www.youtube.com/watch?v=3jzppmp2MQQY>

Një numër të madh tekstesh dhe incizime këngësh,
vjersha dhe tregime të bukura për fëmijë, me tematikë të
ndryshme mund të gjeni në blogun
<http://vogelushet.blogspot.com/>



7. Vendasi i huaj

Një ditë, gjatë pushimit të orës dhjetë, Ariani deshi të luante me një grup fëmijësh. Njëri prej tyre, Peter, nuk e la të luante me ta.

- Ti je i huaj për ne, - i tha ai dhe e shikoi shtrembër.

Ariani u ndal dhe nuk dinte çka të bënte.

- Pse jam unë i huaj këtu?,- iu drejtua ai Petrit. - Unë kam lindur në këtë qytet. Dhe flas të njëjtën gjuhë si ti.

- Por ti je shqiptar, pra nuk je këtu në vendin tënd. Vendi yt është Shqipëria, - tha Nino.

- Unë nuk kam ardhur nga askund, unë kam lindur këtu,- nguli këmbë Ariani.

- Por familja jote ka ardhur,- tha Martini.

- Unë nuk jam fajtor pse familja ime ka ardhur prej andej.- tha Ariani i mërzitur.

Në atë moment erdhi Laura, një vajzë e klasës së gjashtë. Ajo ishte shoqe e ngushtë e Arianit. Nga larg ajo kishte vërejtur që diçka nuk ishte në rregull.

- Pse nuk mund të luajë Ariani me ju?,- pyeti ajo.

- Sepse ai është i huaj për ne, - u përgjigj njëri.

- Ai është një nxënës sikur edhe ju, flet të njëjtën gjuhë sikur ju dhe ju nuk keni të drejtë të mos e lini të luajë,- tha ajo e vendosur.

- Por ai është shqiptar, - tha Petri. - Le të shkojë të luajë me shqiptarët e tjerë, jo me ne.

- Unë mendoj se Laura ka te drejtë, - tha Martini i menduar.- Këtu nuk jemi duke luajtur sipas nacionaliteteve, por një lojë të thjeshtë. Peter, - iu drejtua Martini, - lëre Arianin të luajë me ne. Ai është një djalë i mirë dhe ne asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë problem me të. Petri, i zënë ngushtë, u detyrua ta pranonte Arianin në lojë. Të gjithë luajtën derisa ra zilja për të hyrë në klasë.

1. Përgjigju pyetjeve!

1. Me kë deshi të luante Ariani?
2. Si iu përgjigj Petri dëshirës së tij?
3. Ku kishte lindur Ariani?
4. Kush erdhi pak më vonë?
5. Si iu drejtua Laura grupit të të rinjve?
6. Pse pranoi grupi i të rinjve që edhe Ariani të luante me ta?

2. Plotëso fjalitë!

1. Ariani dëshiron të luajë me grupin e të rinjve, por _____

2. Ariani thotë se ai nuk është i huaj këtu, sepse _____

3. Laura i drejtohet grupit të të rinjve, sepse _____

4. Martini thotë se Ariani mund të luajë me ta, ngase ai _____

3. Diskuto dhe shkruaj!

1. A ke ndonjë përvojë si Ariani? _____

2. Si vepron kur të tjerët nuk të lënë të luash me ta? _____

3. Kur e sheh se dy fëmijë që po grinden, çka bën ti? _____

4. Me kë luan ti më me dëshirë dhe pse? _____



8. Humbe gjuhën, je i humbur

Gjyshi nga malësia u nis për ta vizituar të birin në mërgim. Një brengë ia shqetësonte zemrën. Ishin mbushur tetë vjet që i biri Sokoli kishte ikur nga vendlindja. Ai ishte vendosur në një vend të Evropës. Atje ishte martuar me një vajzë të atij vendi dhe kishte dy fëmijë, Atdheun dhe Shqipen, të cilët i kishte parë vetëm në fotografi.

Sokoli punonte shumë. Kishte bërë pasuri dhe e ndihmonte edhe familjen e tij në Atdhe. Sokoli me nusen e pritën bacën në aeroport. Plaku u mërzit pak, sepse nusja nuk dinte shqip dhe bisedën e saj me plakun e përkthente i biri.

Atdheu dhe Shqipja ishin në shkollë. Kur u kthyen, e përqaftuan gjyshin me mall, edhe pse e shihnin për herë të parë. Gjyshit i rrodhën lotët nga gëzimi. Gjyshi filloi t'i pyeste për shkollën dhe për gjëra tjera. Ata vetëm ngritnin supet dhe shikonin nga i ati. Babai filloi t'i përkthente fjalët e plakut në gjuhën e vendit.

Atdheu e Shqipja nuk dinin shqip. Gjyshit iu ngrit delli i ballit. Sytë iu mbushën me lot. Deshi të ikte, por nuk i punonin këmbët. I biri e kuptoi dhe e qetësoi disi. Plaku vetëm e shikoi me një shikim shumë qortues dhe tha: Ani që u martove me një vajzë të këtij vendi, por nuk bën mirë që nuk ua mëson gjuhën shqipe, së paku fëmijëve të tu. Një njeri që humb gjuhën e vet, është i humbur, biri i babës.

Fjalë dhe shprehje

- | | |
|------------------|-----------------------|
| - nga malësia | - nga një fshat malor |
| - brengë | - vuajtje, merak |
| - ngritnin supet | - çonin krahët |
| - delli i ballit | - damari i gjakut |
| - shikim qortues | - shikim kritikues |
| - fare | - aspak, hiç |

1. Vendos numrin para fjalisë sipas renditjes logjike!

- _____ Atdheu dhe Shqipja e përqaftuan gjyshin.
_____ Plaku shkoi ta vizitonte të birin Sokolin në kurbet.
_____ Gjyshi u mërzit shumë, kur pa se nipi dhe mbesa nuk dinin të flisnin shqip.
_____ Sokoli me nusen e pritën plakun në aeroport.
_____ Plaku e qortoi nipin duke i thënë: Një njeri që humb gjuhën e vet, është i humbur.

2. Përgjigju pyetjeve!

1. Sa vjet nuk e kishte parë gjyshi të birin? _____
2. Kush doli ta priste atë në aeroport? _____
3. Ku ishin Atdheu dhe Shqipja kur arriti gjyshi në banesë? _____
4. Çfarë bënë ata kur e panë gjyshin? _____
5. Si e ndjeu veten gjyshi? _____
6. Çka bënë fëmijët kur gjyshi i pyeste për shkollën? _____
7. Si e ndjeu veten gjyshi kur pa se fëmijët nuk dinin të flisnin shqip? _____

3. Zgjidh njërën nga tri temat vijuese dhe shkruaj për këtë një tekst sa më të gjatë!

- a) Çka do të thotë shprehja "Humbe gjuhën dhe je i/e humbur"?
- b) Përshkruaj një situatë kur të kanë munguar fjalët ose shqip ose në atë të vendit ku jeton!
- c) Përshkruaj një situatë ku i ke përzier dy gjuhët (shqipen dhe atë të vendit): Çka ke thënë, si kanë reaguar njerëzit?

4. Diskutoje tekstin tënd me shokun/shoqen e bankës. A është teksti i kuptueshëm, a ka diçka për të përmirësuar? Pastaj lexojini tekstet në klasë apo bëni një ekspozitë të vogël me to!



Zamir Mati: Pazari i Korçes (pikturë)

9 . Fqinjët tanë

Prindërit e Zanës, Korabi e Vjosa patën ardhur nga Kosova në kurbet para disa viteve. U vendosën në banesë dydhomëshme, në një pallat shumëkatësh. Aty banonte edhe shoku i punës i Korabit, Drini, me të shoqen Mimosën, nga Durrësi i Shqipërisë.

Në këtë pallat jetonin edhe shumë familje të tjera nga shumë vende të Ballkanit, Evropës e të botës: Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, Italia, Turqia, Greqia, Polonia, Maroku, Arabia e shumë e shumë shtete të tjera të botës.

Prindërit e Zanës dhe shoku i babait të saj, Drini, shkonin shumë mirë me të gjithë banorët e pallatit. Përshëndeteshin sa herë takoheshin. Bisedonin dhe mahiteshin me njëri-tjetrin. I ndihmonin njëri-tjetrit sa herë që kishin nevojë. Madje me disa shkëmbenin edhe vizita.

Zana, motra e saj Vlora, vëllai Genti, shoqja Teuta e shoku Dardani nga Durrësi shoqëroheshin me shumë fëmijë të pallatit: me Stelën, Tobiasin, Frankon, Ajshen, Vojtekun, Kirjakosin etj. Shkonin bashkë në shkollë, mësonin e luanin së bashku. Madje ata mësuan edhe përshëndetjet kryesore në gjuhë të ndryshme. Të gjithë banorët e pallatit ishin të kënaqur me sjelljet e njëri-tjetrit.

1. Përgjigju pyetjeve së pari me gojë e pastaj edhe me shkrim!

1. Si quheshin prindërit e Zanës dhe nga janë ata?
2. Si quheshin shoqja e tyre dhe nga janë?
3. Ku banonin këto dy familje?
4. Sa anëtarë kishte familja e Zanës dhe kush ishin ata?
5. Po familja nga Durrësi sa anëtarë kishte dhe kush ishin?
6. Nga cilat vende kishte banorë në pallatin pesëkatesh?
7. Cilat fjali tregojnë se banorët e pallatit kalonin shumë mirë mes vete?
8. Çka bënë së bashku fëmijët e pallatit?

2. T'i shtojmë njohuritë:

Evropa është një kontinent. Kontinente të tjera janë edhe Amerika, Azia, Afrika, Australia etj.

Ballkani është një pjesë e Evropës, ku shtrihen edhe shtetet në të cilat jetojnë shqiptarët.

3. Bisedoni me mësuesen/sin, cilat shtete shtrihen në Ballkan. Shkruani emrat e tyre. _____

4. Shikoni një hartë të Ballkanit dhe shkruani:

a) Me cilat shtete kufizohet Republika e Shqipërisë? _____

b) Me cilat shtete kufizohet Republika e Kosovës? _____

c) Me cilat shtete kufizohet Maqedonia? _____

5. T'i shtojmë njohuritë!

Shumë vajza e djem shqiptarë kanë emra të qyteteve, maleve, lumenjve e luleve ose të personave/fiseve historike. Me ndihmën e mësuesit/mësueses tregoni çka tjetër emërtojnë këto fjalë:

Korabi	është	edhe	një	_____	në Shqipëri.
Drini	është	edhe	një	_____	në Shqipëri.
Vlora	është	edhe	një	_____	në Shqipëri.
Mimoza	është	edhe	një	_____	
Genti	ishte	edhe	një	_____	
Teuta	ishte	edhe	një	_____	
Dardani	ishte	edhe	një	_____	



10. Një dhuratë për gjyshen

Flamuri e do shumë gjyshen e tij. Kur del nga shtëpia për të shkuar në shkollë dhe kur kthehet, Flamuri e përshëndet atë duke e përqaftuar fort. Ai edhe kujdeset gjithnjë për të. E ndihmon të dalë në kopsht dhe të kthehet në dhomën e saj. Shpesh i mbledh lule dhe i vë në vazo afër krevatit të saj. Sa herë që ka pak të holla, që ia japin prindërit për nevojat e tij, ai i blen asaj diçka.

Për ditëlindjen e 80, Flamuri i bleu një shall të bukur. Atë ia dha vonë pasdarke dhe e uroi:

- Me fat ditëlindjen, gjyshe e dashur! Rrofsh edhe shumë e shumë vjet!
Këtë shall e gëzofsh!

Gjyshja u gëzua pa masë, edhe pse nuk ishte hera e parë që Flamuri ia uronte ditëlindjen asaj.

- Të paça, biri i nënës! U rritsh e u plaksh edhe ti! Sa fort më gëzove, o shpirti i lokës, - i tha gjyshja duke e puthur në ballë.

- Sa kënaqësi qenka kur të duan e të nderojnë nipërit e mbesat edhe në pleqëri të thellë, - vazhdoi gjyshja.

Flamuri doli nga dhoma e gjyshes duke e uruar: Natën e mirë e gjumë të rehatshëm, gjyshe e dashur!

1. Radhitni planin e ritregimit duke vendosur numrat prej 1- 9!

- _____ Flamuri doli nga dhoma e gjyshes duke e uruar atë.
_____ Ai edhe kujdeset gjithnjë për të.
_____ Gjyshja u gëzua pa masë.
_____ Flamuri e do shumë gjyshen e tij.
_____ Shpesh i mbledh lule.
_____ Të paça, biri i nënës!
_____ Për ditëlindje, Flamuri i bleu një shall të bukur.
_____ Sa kënaqësi qenka kur të duan e nderojnë nipërit e mbesat!
_____ Me fat ditëlindjen, gjyshe e dashur!

2. Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1. Si vepron Flamuri kur shkon dhe kthehet nga shkolla?
2. Çka e ndihmon ai gjyshen e vet?
3. Çka i vë ai afër krevatit?
4. Çka i bleu Flamuri gjyshes për ditëlindje?
5. Cilat shprehje i përdori ai?
6. Po me cilat shprehje ju falënderua gjyshja?
7. Çka mendoi ajo në atë moment?
8. Si e përshëndeti Flamuri gjyshen duke dalë nga dhoma e saj?
9. Cilën ditëlindje kishte gjyshja?

3. Mësoni këto përshëndetje:

- | | |
|--------------------------------------|-----------------------------------|
| - Me fat ditëlindjen! | - Rrofsh edhe shumë e shumë vjet! |
| - E bëfsh me shëndet! | - U rritsh e u plaksh edhe ti! |
| - Natën e mirë e gjumë të rehatshëm! | - Mirë se erdhët! |
| - Mirë se u gjetëm! | - Lamtumirë! |
| - Mirupafshim! | - Për shumë vjet gëzuar! |

4. Tregoni cilat urime i shkruajmë apo i themi kur :

- dikush ka ditëlindjen: _____
na vjen dikush për vizitë: _____
ndahemi me dikë: _____
gjejmë dikë duke ngrënë bukë: _____
shkojmë për të fjetur: _____
përcjellim dikë në udhëtim: _____
vjen Viti i Ri: _____
dikujt i dhurojmë një xhaketë _____



11. Te mjeku

Pashtriku nuk do të shkojë sot në shkollë, sepse është i sëmurë. Pasi i biri nuk doli nga dhoma e fjetjes, nëna shkoi tek ai, duke menduar se nuk i kishte dalë gjumi. Kur e pa zgjuar që rrinte ende i shtrirë në krevat, iu ul pranë dhe e pyeti:

- Ç'ke, biri i nënës, pse nuk ngrihesh?

- Jam i sëmurë, nënë, – u përgjigj me gjysmë zëri Pashtriku.

Meqë Pashtriku nuk mund të ecte, e ëma mori telefonin dhe e thirri ndihmën e shpejtë, e cila erdhi pas disa minutash. Kur arritën në ambulancë, u paraqitën tek infermierja. Ajo u tha se duhej të prisnin pak, pasi ishin pa termin. Dorëzuan kartelën e sigurimit shëndetësor dhe zunë vend në dhomën e pritjes për pacientë. Nuk kaloi shumë kohë, mjeku i thirri të hynin brenda.

- Çka të dhemb, djalosh? - e pyeri mjeku

- Më dhemb koka dhe më vjen të vjell, zoti mjek, – u përgjigj Pashtriku.

- Po temperaturë a ke? - pyeti mjeku në vazhdim.

- Po, zoti mjek. Nga ajo edhe më zënë ethet, - ia ktheu Pashtriku.

Mjeku mori termometrën dhe ia matì temperaturën. E pa se termometri arriti në 39 shkallë. Pastaj mjeku mori stetoskopin dhe filloi ta dëgjonte së pari në gjoks e pastaj edhe në shpinë.

- Po, kolla a të merr? - pyeti mjeku.

- Po, zoti mjek, gjatë natës kisha edhe kollitje.

-Je ftohur, Pashtrik, për çka duhet të kesh kujdes – i tha mjeku. -Në shkollë nuk mund të shkosh tri ditë. Për këtë do ta marrësh dëshminë, për arsyetimin e mungesave. Unë po të shkruaj recetën për barna, të cilat duhet t'i marrësh rregullisht. Pastaj duhet të pish edhe çaj dy deri tri herë në ditë dhe do të të kalojë ftohja.

Mjeku mbaroi këshillën. Ia zgjati dorën dhe u përshëndetën duke i thënë njëri- tjetrit ditën e mirë.

1. Radhitni planin e ritregimit sipas kuptimit logjik duke vendosur numrat 1-8!

_____ Mjeku ia mati temperaturën me termometër.

_____ E ëma shkoi të shihte se përse Pashtriku nuk zgjohej nga gjumi.

_____ Mjeku e këshilloi të mos shkonte në shkollë dhe t'i merrte rregullisht barnat.

_____ Pashtriku i tregoi mjekut se i dhembte koka, kishte temperaturë dhe kollitej.

_____ Pasi dëgjoi edhe me stetoskop, mjeku i tha se ishte ftohur.

_____ Pasi pritën pak, mjeku i thirri brenda dhe e kontrollloi Pashtrikun.

_____ Pashtriku nuk do të shkonte në shkollë sepse ishte i sëmurë.

_____ Nëna e thirri ndihmën e shpejtë dhe e dërgoi Pashtrikun në ambulancë.

2. Luani rolin e mjekut dhe të pacientit, që mësuesi dhe nxënësit e tjerë t'ju dëgjojnë!

Zgjidhni fituesit: kush e ka luajtur më mirë rolin e pacientit dhe të mjekut.

3. Përgjigju këtyre pyetjeve me gojë ose me shkrim!

1. Pse Pashtriku nuk do të shkojë në shkollë?

2. Çka bëri e ëma kur pa se Pashtriku nuk po dilte nga dhoma e fjetjes?

3. Me çka e dërgoi nëna Pashtrikun në ambulancë?

4. Pse u desh që Pashtriku të priste pak në dhomën e pritjes?

5. Çka i dhimbte Pashtrikut?

6. Me çka ia mati mjeku temperaturën Pashtrikut?

7. Po me çka e dëgjoi ai atë?

8. Çka duhet të marrë rregullisht Pashtriku për t'u shëruar?

4. Shkruani në gjuhën e vendit ku jetoni këto shprehje:

mjeku _____

infermierja _____

ndihma e shpejtë _____

ambulanca _____

dhoma e pritjes për pacientë _____

më dhemb koka _____

kam temperaturë _____

kollitem _____

më zënë ethet _____

më vjen të vjellë _____

barna/ilaçe _____





12. Një ditë pushimi

Është mëngjes. Agimi zgjohet herët, shikon orën dhe menjëherë ngrihet nga shtrati. Rregullon krevatin e pastaj hap dritaren. Ai sheh se koha është shumë e bukur. Qielli është i kaltër. Nuk ka asnjë re dhe dielli ndriçon. Sot është ditë pushimi. Agimi dhe familja e tij do të bëjnë një shëtitje në parkun e qytetit. Prindërit e Agimit gati çdo të diel e kalojnë kohën e lirë diku jashtë shtëpisë. Pos në park, ata shkojnë në kinema, pishinë e në kopshtin zoologjik. Nganjëherë vizitojnë edhe monumentet kulturore në qytetet e afërta.

Agimi largohet i kënaqur nga dritarja. Bën gjimnastikën e mëngjesit, pastron fytyrën, dhëmbët dhe vishet. Pastaj shkon në kuzhinë, ku e presin nëna, babai dhe motra e tij Valdrina. Të gjithë ulen në tryezë, hanë mëngjesin dhe bisedojnë për shëtitjen.

Pas mëngjesit nëna dhe Valdrina mbushin çantat me ushqime e pije të nevojshme. Babai dhe Agimi marrin batanijet, topin e gjëra të tjera për lojë. Në orën 9 nisen nga shtëpia. Kur arrijnë në park, i gjejnë edhe shumë shokë e shoqe të lagjes e të shkollës. Prindërit e tyre bisedojnë e luajnë shah e letra, kurse fëmijët luajnë me top, lojën kukafshehti, lojën me xhita e shumë lojëra të tjera. Dita kalon shumë shpejt. Në mbrëmje kthehen në shtëpi. Të gjithë janë të lodhur, por të kënaqur.

1. Përgjigjuni pyetjeve me gojë: Njëri nxënës/e pyet, tjetri/a përgjigjet.

- Kur zgjohet Agimi? Ç'bën Agimi pasi zgjohet? Si është koha? Ku duan të shkojnë sot familja e Agimit? Ku shkojnë ata ditën e diel? Ç'bën Agimi pasi largohet nga dritarja? Kush e pret atë në kuzhinë? Për çka bisedojnë prindërit dhe motra e Agimit? Me çfarë i mbushin çantat nëna dhe motra Valdrina? Çfarë marrin babai dhe Agimi? Kë gjejnë në park Agimi dhe Valdrina? Cilat lojëra luajtën prindërit? Po cilat lojëra luajtën fëmijët? Kur kthehen nga shëtitja në shtëpi, si ndjehen?

2. Përgjigjuni me shkrim këtyre pyetjeve:

Kur zgjohesh të dielave? _____

Çfarë bën ti pasi zgjohesh? _____

Ku shkon zakonisht këtë ditë pushimi? _____

Ku të pëlqen më shumë? _____

Me kë shkon? _____

Me cilët shokë luan gjatë të dielave? _____

Nga janë shokët me të cilët luan? _____

Cila lojë të pëlqem kur luan jashtë? _____

Cila lojë të pëlqen kur luan brenda? _____

3. Shkruaj në një fletë të veçantë ku, me kë dhe si e ke kaluar një të diel posaçërisht të bukur. Bëj edhe një vizatim. Lexoje tekstin para klasës!



13. Ç' do të bëhem

1.

Në u bëfsha traktorist,
murator, elektrikist,
gjeolog a infermier
do të punoj kudo me nder.

2.

Po të bëhem aviator,
marinar a minator
do të punoj unë me gëzim
për lavdinë e vendit tim.

3.

Në u bëfsha farkëtar,
rrobaqepës, këpucar,
djersën time pa kursim
do t'ia fal vendit tim.

4.

Se ç' do të bëhem s' e di,
se akoma jam fëmijë,
por sot duhet të mësoj
Që të di si të punoj.

B. RAMA

Të mësojmë edhe këtë: Disa profesione quhen edhe zanate apo mjeshtëri.
P.sh. farkëtar, këpucar, rrobaqepës etj.

1. Shkruani

Çka është me profesion babai yt? _____

Ku punon ai? _____

Po nëna jote çka është me profesion? _____

Çka punon ajo? _____

Cili profesion të pëlqen ty? _____

Çfarë shkollash duhet t'i kryesh për ta bërë profesionin tënd të preferuar?

2. Shkruaj ku punojnë:

Mësuesi _____.

Mjeku _____.

Bukëpjekësi _____.

Kamarieri _____.

3. Shkruani fjalët për profesionet e tjera duke biseduar me mësuesin/en.

Për këtë do t'ju ndihmojnë edhe këto pyetje:

Kush...

... zien gjellën, shkurton flokët, shkruan libra, pastron shkollën, bart postën, luan në teatër, punon tokën, shëron dhëmbin, këndon këngën, drejton aeroplanin, drejton anijen, ndreq këpucët,...

shqip	në gjuhën e vendit ku jeton ti
1. _____	_____
2. _____	_____
3. _____	_____
4. _____	_____
5. _____	_____
6. _____	_____
7. _____	_____
8. _____	_____
9. _____	_____
10. _____	_____
11. _____	_____
12. _____	_____



14. Si e ëndërroj të ardhmen time

Shpresa, Besniku, Artani, Arditi, Lura, Ardita dhe Fatimiri janë në klasën e pestë dhe mësojnë mirë. Ata flasin shumë mirë gjuhën e shkollës dhe gjuhën shqipe. Po ashtu mësojnë edhe gjuhën angleze. Një ditë mësuesja bisedoi me nxënësit e klasës.

- Kur unë isha e vogël ëndërroja të bëhesha mësuese dhe ja tash jam mësuese juaja. Po ju çka ëndërroni të bëheni kur të rriteni? – pyeti ajo.

- Unë kur të rritem dëshiroj të bëhem stjuardesë. Është bukur të vizitosh shumë vende të ndryshme, të ndalesh në shumë qytete e të mësosh shumë gjuhë të huaja, - tha Besa.

- Unë dëshiroj të bëhem pilot, - tha Fatmiri. - Më pëlqen shumë kostumi i pilotit.

- Bukur, - e vazhdoi bisedën mësuesja. - Secili nga ju, pas shkollimit që do kryeni, do bëhet me profesion të ndryshëm. Secila punë kërkon shkathtësi të caktuar. Që të ia arrini kësaj është e domosdoshme dashuria e juaj ndaj punës. Ju duhet të jeni të vendosur në rrugën drejt ëndrrës suaj. Me punën tuaj do të fitoni për të jetuar mirë e me nder.

Secili nxënës në një kartelë shkroi disa fjali, se si e ëndërron veten kur të rritet. Pas pak çastesh ata i lexuan në radhë ato dhe biseduan lidhur me ëndrrat e tyre për të ardhmen.

bibliotekist /arkeolog /kuzhinier/arkitekt/mjeke /pilot /mësuese

1. Lexo kartelat e secilit dhe plotësoje emrin e profesionit!



„Më pëlqen të zbuloj gjëra të vjetërsisë nga njerëzit në të kaluarën, kulturën e tyre, mënyrën e jetës, zakonet, veglat e punës” - shkroi Besniku. -----



„Ëndërroj të bëhem ----- sepse dua të ofroj libra për lexues. Njerëzit që lexojnë më lënë përshtypje me kulturën e tyre” - Shpresa



„E dua shumë profesionin e babait tim. Ai është ----- . Ka projektuar disa ura mbi lumën Drin, ndërtesa në Strugë dhe qytete tjera” - Arditi.



„Kur të rritem do të bëhem ----- . Më pëlqen të mësoj të gatuj mirë veçanërisht gatimet shqiptare” - Artani



„Ëndërroj të bëhem ----- . Dua t'u ndihmoj njerëzve të sëmurë që të shërohen”. Ardita



„Mua më pëlqen të bëhem ----- dhe të fluturoj mbi qytete, fshatra, fusha, male, dete” - Fatmiri

KËNDOJMË

Ja dhe një këngë e bukur për shokët të cilët kujtojnë fëmijërinë e tyre kur kishin shumë ëndrra për të ardhmen.

Teksti: Betim Muco

Muzika: Sh.Kodra

Shokët

Kur i-shim fë-mij, ë-ndë-rronim ne t'ardh-men ton'
më të bu-kur se çdo ë-ndë-rrim. Rrje-dhin vi-tet shok'
sot at-dhe-u djers' na kër - kon ndaj pas zë-rit t'tij ne sot vra-pojm'
Kjo është rru - ga jon' Ri-ni - a jon' o shtat he-dhu-ra
Me ba-llin lart, o e bu-ku-ra! Me ty jam gjith -
mon, ku na kër - kon ko - ha sot Nuk ka në bot'
o, si je - ta jon' Në rru-gët e saj e - cim ne, o
shok' me ju jam' gjith - mon ku zë - ri at - dhe - ut na kër-kon.



15. Si banojnë fëmijët e një klase

- Banesa është hapësira ku ne jetojmë në kohën më të madhe. Hapësirat e pajisura me orendi e lehtësojnë jetën tonë. Aty qetësohemi, flemë, mbajmë pastërtinë, mbajmë higjienën personale, kryejmë detyrat e përditshme, luajmë me lodra e shumë nevoja të tjera jetësore. Çdo banesë nuk ofron kushte për jetë të mirë. Banesat dikur ishin të ftohta, pa izolues dhe ngrohje qendrore. Në kohët e sotme shumë njerëz banojnë në ndërtesa të mëdha me shumë banorë. Ata duhet zbatuar rregullat e sjelljes së banimit. Në fshat banohet në shtëpi të ndërtuara për një familje apo pak familje. Atje ka qetësi e gjelbërim, kurse në qytete banojnë shumë familje së bashku në një ndërtesë, - e filloi bisedën mësuesja.

Biseda vazhdoi me të gjithë nxënësit. Secili tregonte me radhë se si dukej banesa e tij.

- Unë banoj në katin e pestë, në një ndërtesë të vjetër. Jemi pesë veta, dy prindërit dhe tre fëmijë. Kemi dy dhoma e një kuzhinë të vogël. Nuk kemi ashensor, por shkallë, – tregoi Vjollca.

- Po ti, Shkodran, do ta përshkruash banesën tënde?- pyeti mësuesja.
- Po, zonja mësuese, - u përgjigj Shkodrani. – Unë banoj në katin përdhese bashkë me familjen time. Nëna është e sëmure dhe nuk punon. Babai e mban pastërtinë në banesë, por i ndihmojmë edhe ne fëmijët. Jemi katër anëtarë të familje dhe kemi tri dhoma e një kuzhinë të vogël. Babai thotë se nuk kemi para të paguajmë banesë të mirë. Ngrohjen e banesës e bëjmë me stufë thëngjilli.

- Unë banoj në katin e njëmbëdhjetë, - e filloi Blerta bisedën. – Banesa jonë është e bukur. Kemi dhomë pritjeje, dhomë fjetje dhe dhomë fëmijësh, banjë, toalet, ngrohje qendrore, garazhe në bodrum. Unë kujdesëm për lulet dhe papagajtë e mi, Flatrën dhe Kaçurrelin. Ndërtesa ka ashensor dhe është e rrethuar me park të gjelbëruar, ku ne luajmë.

Secili nxënës e përshkroi me fjalë banesën e tij. Ata në fund shkruan disa fjali rreth banesës dhe mbajtjes së saj nga anëtarët e familjes. Të gjithë fëmijët treguan se luajnë së bashku me fëmijët e lagjes në këndin për lojë të parkut. Ata flasin në gjuhën e shkollës dhe e duan njëri-tjetrin. Shumë nga fëmijët e ndërtesës vijnë nga vende të ndryshme të botës dhe flasin me prindër në gjuhën e tyre.

1. Bisedoni në grup, pastaj shkruaj në fletore përgjigjet që i keni gjetur!

1. A ka banesa e Vjollcës ashensor?
2. Cilat hapësira banimi i ka banesa e Blertës?
3. Çka janë Flatra dhe Kaçurreli?
4. Ku luajnë së bashku fëmijët e lagjes?
5. A duhet mbajtur rregullat e banimit dhe pse?
6. Ku luan ti me shokët e shoqet e tua?

2. Shkruaji disa fjali për banesën tënde! _____

3. Bisedoni me prindërit dhe me gjyshërit tuaj se si banonin ata dikur. Shkruaje me disa fjali, përgatit një rrëfim/një prezantim 5- deri 10-minutësh para klasës. Mund të bësh edhe një poster/një pllakat me fotografi dhe tekst.

4. Përktheji fjalët në gjuhën e vendit ku jeton!

banesë _____;

ndërtesë _____;

dhomë _____;

stufë _____;

qetësi _____;

kat _____;

ashensor _____;

izolues _____;

lagje _____.

5. Bëje një vizatim të shtëpisë sate të ëndrrave! Mund të shkruash edhe ca fjali, kështu që të tjerët e kuptojnë mirë.



16. Një vizitë në muzeun e qytetit

Një ditë, para se të nisemi për vizitë në muzeun e qytetit, mësuesja na u drejtua me këto fjalë:

- Kudo që të jemi, duhet të sillemi mirë. Në familje, në shkollë po edhe në hapësira të tjera. Gjithherë të mendojmë që të mos i pengojmë të tjerët, veçanërisht në vendet publike.

U rreshtuam, kurse ne, kureshtarë për të parë e për të mësuar gjëra të reja, ecnim me kujdes dhe disiplinë. Rrugës takuam edhe prindër të cilët përshëndetnin dhe kënaqeshin kur na shikonin kështu të rreshtuar bukur.

Në paradhomën për vizitorë të muzeut na dëshiroi mirëseardhje shoqëruesi. Ai i propozoi shoqes sonë të klasës, Luljetës, që ta lexonte udhëzuesin e mirësjelljes që ta dëgjonin të gjithë.

Ajo lexoi:

Rregullat e mirësjelljes në muzeun e qytetit

1. Të mos i pengojmë vizitorët e tjerë.
2. Secili të qëndrojë afër grupit dhe të ruajë radhën.
3. Të mbajë disiplinë, të mos shtyjë të tjerët dhe të mos bëjë zhurmë.
4. Të mos i prekë eksponatet.
5. Të mos i kalojë me lëvizje duarsh shiritat e verdhë, sepse kjo e aktivizon sistemin e alarmit.

Për çdo gjë e ngritni dorën dhe pyetni mësuesen dhe shoqëruesin. Hapësirat e muzeut ishin të mbushuar edhe me vizitorë të tjerë. Ishte qetësi. Shoqëruesi fliste me një zë pëshpëritës, por të qartë. Ne mësuam shumë gjëra mbi të kaluarën e paraardhësve tanë. Shoqëruesi në fund na përgëzoi për rregullin e mbajtur. Ne mbetëm të kënaqur nga sjellja e shokëve dhe e shoqeve të klasës. Edhe mësuesja.

1. Përgjigju këtyre pyetjeve:

1. Ku shkoi për vizitë klasa e Luljetës?
2. Si duhet të sillemi ndaj të tjerëve?
3. Çka lexoi Luljeta në paradhomën e muzeut?
4. Çka mësuam nxënësit në Muzeun e Qytetit?
5. Përse i përgëzoi shoqëruesi i muzeut nxënësit?

2. Përkruaj katër rregulla të cilat ju keni përfillur me rastin e ndonjë vizite në një muze apo ekspozitë me klasën tuaj!

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

3. Çka të ka pëlqyer më shumë në muze apo në ekspozitë? _____

4. Shkruaj se si duhet të sillemi në muze: _____

5. Kërko në internet: Muzeu Kombëtar në Tiranë; Muzeu i Kosovës në Prishtinë. Shkruaj çka ke gjetur. Tregoje në klasë!



17. Rolet e vajzave dhe të djemve

- Ju, nxënës të dashur, të gjithë keni lindur nga prindërit tuaj, nëna dhe babai. Edhe ata ishin dikur fëmijë. Ju keni ngjashmëri me ta, dikush më shumë e dikush më pak, – shpjegoi mësuesja.

- Mësuese, a mund të flas unë? – e ngriti dorën Vjollca.

- Urdhëro, Vjollcë! – i dha leje mësuesja.

- Unë i përngjaj me fytyrë nënës aq shumë sa ata që e njohin nënën time kur më takojnë më thonë „kryekëput nëna e saj”. Flokët i kam me ngjyrë gështenjë të njëjtë me babanë, - vazhdoi Vjollca.

Shumica e nxënësve ngritën duart për të marrë leje për të folur.

- Këtë bisedë do ta lëmë për më vonë, kurse tash dëgjoni,-iu drejtua mësuesja. - Gjysma e njerëzve janë të gjinisë mashkullore dhe gjysma të gjinisë femërore. Po ashtu në klasën tonë gjysma janë vajza e gjysma djem. Të gjithë keni dëshirë të luani, të argëtoheni e të mësoni. Lodrat, që i adhuroni secili, janë të ndryshme. Pra dëshirat mund të jenë të ngjashme, por edhe të ndryshme. Duke u rritur ndryshojnë dëshirat, ndjenjat dhe vetë pamja e individit. Individ është secili nga ju.

E di se shumë fëmijë interesohen të dinë lidhur me trupin e tyre. Andaj besoj se do të më dëgjoni me vëmendje.

Trupi i njeriut ndryshon vazhdimisht gjatë jetës së tij. Nga foshnja, e cila nuk flet, nuk ka dhëmbë, nuk ecën... do të zhvillohet fëmija, i cili flet, i dalin dhëmbët, ecën e rritet shpejt. Një fazë e rëndësishme tjetër që vjen është puberteti.

- Çka do të thotë pubertet, zonja mësuese? - pyeti Besarta.

- Është kjo moshë kur trupi i vajzave zhvillohet në trup gruaje, e cila fillon nga moshë dhjetëvjeçare. Vajzat rriten shpejt, zëri u ndryshon, në veçanti zgjerohet gjoksi, po bëhen edhe ndryshime të tjera trupore. Ato duhet ta dinë se në marrëdhënie dashurie me djem mund të mbesin me barrë. Në këtë kohë vajzat kanë kujdes ndaj higjienës personale si faktor i shëndetit dhe bukurisë fizike.

- Po djemtë, zonja mësuese, çka ndryshojnë? - pyeti Valmiri.

- Te djemtë puberteti fillon pak më vonë. Ata nisin të burrohen, u trashet zëri, fillon t'u dalin mjekra e mustaqet, u zgjerohet kraharori dhe fytyra e tyre është e skuqur me puçrra. Muskujt e tyre zhvillohen dhe ata bëhen të fuqishëm, rritet interesimi i tyre për vajza. Ata janë të kujdesshëm ndaj higjienës personale dhe më emocionale.

- Edhe ju, nxënësit e mi, që nga kjo moshë filloni të rriteni e të zhvilloheni më shpejt. Duhet të lexoni dhe t'i njihni mirë ndryshimet trupore. Trupi juaj u takon vetëm juve. Ju duhet të shtoni kujdesin, të mësoni dhe t'i njihni mirë ata me të cilët shoqëroheni apo keni kontakte rasti. Për trupin tuaj vendosni ju vetë.

Djemtë duhet të respektojnë vajzat.

- Edhe unë do të kem mustaqe e mjekër, mësuese, - tha Genti duke bërë me dorë mjekrën.

Të gjithë qeshën.

1. Shëno tri pikat nga teksti i mësipërm, të cilat të duken më të rëndësishmet apo më interesantet! Krahasoju dhe diskutoji me shokun/shoqen e bankës dhe me gjithë klasën!

2. Diskutoni dhe përgjigjuni pyetjeve vijuese:

1. Kujt i ngjajmë më shumë?
2. Sa femra e sa meshkuj ka klasa juaj?
3. Çka është puberteti?

3. Përgjigju pyetjeve vijuese me shkrim!

1. Çfarë ndryshimesh pëson trupi i vajzave në pubertet? _____

2. Çfarë ndryshimesh pëson trupi i djemve në pubertet? _____

3. Çka duhet të dinë djemtë e vajzat në pubertet? _____

4. Si e respekton shoqërinë e gjinisë tjetër? _____

5. A do të doje të ishe i gjinisë tjetër dhe pse? _____

6. Informohu në internet mbi pubertetin! Trego në klasë çka ke mësuar!



Violeta Xhaferi:
Drenicajka

18. Trupi im më përket mua

Dy javë zgjati projekti „Trupi im më përket mua”. Shkolla jonë ishte mbushur me vizatime, shkrime, pllakate. Eva kishte vizatuar një sulm nga një rrugaç, Kristina një lule të madhe me fotografinë e saj në mes. Në çdo petale kishte shkruar fjalët: vigjilencë, informim, paqe, shoqëri, dashuri, korrektësi.

Eminja, e cila vinte nga Turqia, e kishte vizatuar portretin e vajzës, kurse anash saj fjalët: „Dëshira juaj nuk është detyrim për mua” „Unë vendos për veten time.”

Këndi i Emirës ishte përplot. Aty dielli nga qielli i kaltër rrezatonte vizatimet. „Çka s'të kënda ty mos ia bëj tjetrit” dhe „E mira e ka të mirën”.

Filipi i kishte shkruar fjalët e Nënës Tereze në një zemër të kuqe: „Dashuria do ta shpëtojë botën” në gjuhën e shkollës, anglisht dhe shqip.

Petra në një flamur tringjyrësh e kishte vendosur portretin e saj dhe një kusar me ngjyrë të zezë. Ajo në tri ngjyra kishte shkruar: „Jo! dhunës - Po! mirësisë” dhe tituj nga gazetatat ku shkruante: „U rrëmbye vajza nga njerëz të panjohur” ; „u sulmua i riu në tren” ; „Në shkollën e qytetit u rrahën nxënësit” dhe në anën tjetër këndi me titujt e shtypit: „Shoku e shpëtoi shoqen nga sulmuesit”; „Vajza që shpëtoi plakën”; „Jemi shokë nga e gjithë bota”. Të gjitha këto shkëlqenin nga larmia e ngjyrave.

Pllakati i Ronaldos ishte vendosur në një tavolinë. Mbi të ishte shkruar: „Jo dhurata nga njerëz të panjohur”; „Jo bisedë me të panjohur në rrugë”;

„Jo ofertave nga të panjohurit”. Një figurë engjëlli në mur ,krahët e të cilit ishin ngjyrosura me figura duarsh të nxënësve.

Ditën e publikut erdhën shumë prindër,qytetarë dhe gazetarë. Ata u mrekulluan me punën e nxënësve. Fotografonin, incizonin, intervistonin. Atë ditë erdhi edhe kryetari i bashkisë. Ishte njeri i thinjur, i gjatë, me mjekër të hollë dhe me mustaqet vesh më vesh. Pasi na përgëzoi, bëri fotografi me ne .

Nxënësit ciceronë atë ditë kishin shumë punë. Secili vizitor donte të dinte për projektin. Mësuesja na ndihmonte kur ne kishim nevojë.

Në orën trembëdhjetë klasa e jonë u paraqit me lojën teatrale. „Trupi im më përket mua”. Ishte drama e pagatitur prej nesh. Tema e saj ishte lufta kundër dhunës ndaj fëmijëve e të rinjve. Nga kjo dramë me dy akte ne fituam besim në vetvete, në mbrojtjen tonë nga njerëzit e këqij. Ne mësuam se si duhet reaguari në situata të caktuara dhe të kërkojmë ndihmë. Publiku nga prindër e qytetarë të tjerë na përcolli me duartrokitje. Kryetarja e bashkësisë së prindërve na falënderoi për shfaqjen e mirë.

1. Përgjigju pyetjeve vijuese me gojë ose me shkrim!

1. Si quhej projekti?
2. Çka shkroi Kristina në petale?
3. Çka shkruan Filipi në pllakatin e tij?
4. Çka shkroi Petra në flamurin tre ngjyrësh?
5. Kush e vizitoi shkollën në ditën e publikut?
6. A duhet të marrim dhuratë nga njerëzit e panjohur? Pse po ose jo?

2. Shkruaj një situatë ku ti ke refuzuar ofertë nga të panjohur!

3. Fëmijët në tregimin tonë kanë bërë vizatime për temën “Trupi im më përket mua”. Bëj edhe ti një vizatim të tillë! Bëni një ekspozitë me vizatimet, prezantojini dhe diskutojini!

4. A ka diçka që të shqetëson/të frikëson në lidhje me temën “Trupi im më përket mua”? Shkruaje, nëse dëshiron, apo diskutoje me mësuesen/in.

5. Përshkruaj ndonjë projekt të ngjashëm me këtë në shkollë dhe klasën tuaj. Nëse s’keni pasur një projekt të ngjashëm, mendo çka të interesonte në projektin me temën “Trupi im më përket mua”.



19. Albana i ndihmon fqinjët e rinj

Albana me familje jeton në një lagje qyteti. Ajo është e shoqërueshme dhe ka shokë e shoqe të ardhur nga shumë vende të tjera. Në familje Albana jeton me gjyshin e saj. Ai gjithmonë e këshillon Albanën që të sillet mirë. Një ditë i tha asaj:

- Bija ime, përveç që duhet të sillesh mirë, duhet edhe t' u ndihmosh të tjerëve kur ke mundësi. Bëhu besnike dhe e sinqertë gjithmonë!
- Po, gjysh, por më trego çfarë do të thotë besnike, - u përgjigj Albana.
- Bija ime, besnike do të thotë, fjalën që e thua ta realizosh, ta mbash premtimin dhe të mos gënjesh asnjëherë. Besa është një virtyt i lashtë i shqiptarëve. Shqiptari kur e ka dhënë një premtim e ka mbajtur. Të tjerët e kanë pëlqyer besën shqiptare, bile kanë shkruar edhe libra për këtë, - shpjegoi gjyshi.
- O, gjysh, unë këtë nuk e kam ditur, qenka diçka e bukur! - tha Albana.
- Gjithmonë duhet respektuar shoqja, shoku, fqinjët e në veçanti mysafiri, - vazhdoi gjyshi. - Nuk thuhet kot në fjalën popullore: „Do jesh i respektuar aq sa i respekton të tjerët“

- Dëshiron të të tregoj diçka, gjysh?- pyeti Albana.
- Urdhëro, bija ime! – iu përgjigj gjyshi.
- Këtu në lagjen tonë kanë ardhur fqinjë të rinj. Ata një ditë më pyetën se ku ndodhet ambulanca, nisi rrëfimin Albana.
- Po ti si veprove, u tregove? – pyeti gjyshi.
- Ata ishin të posaardhur dhe nuk e flisnin mirë gjuhën. Jo vetëm që u tregova, por së bashku me Yllin e Josefinën i shoqëruam derisa shihej ambulanca. Ne i treguam edhe numrin e telefonit të ndihmës së shpejtë dhe barnatoren aty afër.
- Të lumtë, Albanë! Unë jam krenar me ty. Fqinji i ri duhet ndihmuar më shumë sesa të tjerët. Edhe ne kur erdhëm në fillim na ndihmuan të tjerët. Njeriu duhet ndarë të mirën dhe të keqen me të tjerët.
- Çfarë është kjo e keqe që duhet ndarë gjysh?
- Jeta ka edhe vështirësi e raste që ne nuk i duam. Bie fjala, vërshimet, zjarri, tërmeti e fatkeqësi të tjera natyrore. Këto kapërcehen më lehtë po e ndihmuam njëri-tjetrin. Apo jo, bija ime!
- Po, gjysh, edhe unë jam krenare që kam një gjysh kaq të ditur.
- Faleminderit, bija ime! - tha gjyshi i lumtur.

1. Përgjigju këtyre pyetjeve me shkrim në një fletë të veçantë!

1. Ku jeton Albana?
2. Me kë jeton Albana në familje?
3. Çfarë e porosiste Gjyshi Albanën?
4. Çka do të thotë fjala “besë”?
5. Kë e ndihmoi Albana?
6. Pse gjyshi i tha Albanës :,,Unë jam krenar me ty”.
7. Çfarë do të thotë ta ndash të mirën dhe të keqen me të tjerët.

2. Përshkruaje me pak fjali një situatë kur i ke ndihmuar njerëzit në nevojë! _____

3. Lexo fjalitë dhe shëno ato pozitive me + (plus) dhe negative me – (minus)!

I ndihmon fqinjët.			Ndot muret me shkrime.		
Vrapon në rrugë.			Nuk i ofendon të tjerët.		
E pengon lojën.			I ndihmon të verbërit		
I ndihmon të vjetrit.			I gënjen prindërit.		
Nuk bën zhurmë.			Nuk i ofendon të tjerët.		
Merr leje për të pyetur.			Nuk gënjen, është besnik.		

4. Shkruaj, si ke përjetuar ndonjë ndihmë nga të tjerët! _____

5. Lexo në internet mbi besën shqiptare, si ishte dikur. Bisedo me prindërit tuaj rreth saj. Shkruaje si tekst të veçantë dhe lexoje para klase.



20. Dëshirat e përafërta

Besniku dhe Valbona vijojnë mësimin plotësues në gjuhën shqipe çdo të mërkurë pasdite. Ata e presin me gëzim këtë kohë, sepse aty mësojnë plot gjëra të reja, të cilat nuk i mësojnë në mësimin e përditshëm.

Një të mërkurë mësuesja e shkollës shqipe, Arbnora, u tha nxënësve se do të mësonin një tregim që kishte të bënte me kulturat e ndryshme. Besniku e Valbona e shikuan mësuesen gjithë kureshtje, sepse një temë të tillë e kishin mësuar edhe në shkollën e rregullt.

Pasi mësuesja i ftoi nxënësit të uleshin në rreth, ata filluan një diskutim interesant.

- Në klasën time ka shumë nxënës, familjet e të cilëve kanë ardhur nga vende të ndryshme, - tha Armendi. Disa nxënës vendas na thonë që ne jemi të huaj. Por gati të gjithë nxënësit e klasës sime kanë lindur këtu. Unë e dua edhe qytetin këtu ku jetoj, por e dua edhe Kosovën, sepse është Atdheu im, - tha ai.

- Nga inati që na thonë kështu, disa prej nesh ua kthejmë atyre duke u thënë se ata janë frikacakë, - tha Zana.

- Po ata si kanë reaguar?- pyeti mësuesja.

- Ata na e kthejnë se nuk janë frikacakë, bile janë më trima se ne. Kurse njëri nga nxënësit na ka quajtur neve rrahësa, - tha Zana.

- Pra ju e keni lënduar njëri-tjetrin pa argumente, - shtoi mësuesja.
- Po, mësuese, por pse ata fillojnë të parët duke na thënë neve ashtu?- foli Gjoni.
- Kur dikush të thotë ndonjë fjalë të rëndë, kjo nuk të jep të drejtë të bësh edhe ti ashtu,- tha mësuesja.
- Edhe mësuesja e klasës sonë na ka thënë të gjithëve se duhet ta respektojmë njëri-tjetrin, pa marrë parasysh se kush është dhe nga është, por nganjëherë nuk u përmbahemi këtyre rregullave, - tha Memli.
- Çfarë do të ndodhte sikur të gjithë të lavdërojnë vetëm veten e tyre dhe të fyejnë të tjerët? – pyeti mësuesja.
- Nxënësit ranë në mendime. Atyre iu kujtuan shokët e shoqet e shkollës. Disa ishin nga Turqia, të tjerë nga Italia, pastaj nga Kosova, Portugalia, Spanja etj.
- Do të bëhej rrëmujë, - tha Brisilda.
- Por të gjithë ju keni shumë gjëra të përbashkëta, - vazhdoi mësuesja, - ju jeni fëmijë, keni plot dëshira të përafërta, flisni gjuhë të ndryshme, por flisni të gjithë edhe gjuhën e vendit ku jetoni.
- Pastaj mësuesja u lexoi atyre një tregim për një djalë që kishte emigruar me familjen dhe kishte arritur shumë shpejt të bëhej ndër nxënësit më të mirë të shkollës.

1. Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë u tha mësuesja nxënësve se do të mësonin në shkollën shqipe?
2. Kë e do Armendi?
3. Çfarë u thonë disa nxënës vendas fëmijëve të ardhur nga vende të ndryshme?
4. Si u kundërpërgjigjen ata?
5. Si i kishte këshilluar mësuesja e klasës së rregullt?
6. Çfarë kanë të përbashkët të gjithë nxënësit?

2. Diskuto së pari me shokun/shoqen e bankës, pastaj në klasë!

1. Si shkon me kolegët/ koleget e shkollës?
2. Cilët janë shokët e tu më të mirë?
3. A ke pasur rast të jesh në konflikt me dikë? Pse?
4. Çka mendon ti se si është më së miri të zgjidhen konfliktet?

3. Trego për veten tënde!

1. Cilat shtete i ke vizituar? _____

2. Cilat gjuhë i flet? _____

3. Përpos shokëve shqiptarë dhe shoqeve shqiptare, a ke shokë nga nacionalitetet e tjera? Nga cilat nacionalitete dhe si quhen ata? _____

4. Zgjero njohuritë!

Familja jote ka mërguar nga trojet shqiptare. Shkruaj kur ka mërguar ajo. Pyeti prindërit e tu se cilat kanë qenë përpjekjet e tyre për t'u integruar në jetën e vendit ku jeton tash?

5. Bisedojmë!

Sa anëtarë ka familja jote?

Prej nga ka ardhur familja jote?

Ku ke lindur ti?

Kë prej farefisit tënd e ke në atdhe?



Kolë Idromeno: Pamje nga Ulqini

Nexhat Maloku, Rifat Hamiti, Hazir Mehmeti
UNË DHE TË TJERËT
Fletore tematike - për nivelin e dytë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në prill 2012

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18:38(076.1)

811.18:37(076.1)

Maloku, Nexhat

Unë dhe të tjerët: fletore tematike për nivelin e dytë /

Nexhat Maloku, Rifat Hamiti, Hazir Mehmeti.

- Botimi i parë. - Pejë: Dukagjini, 2012. - 56 f.: ilustr, me ngjyra; 28 cm.

1. Hamiti, Rifat 2. Mehmeti, Hazir

ISBN 978-9951-05-249-8

Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,

të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 813-304, të datës 14.02.2012